

PROCESVERBAL - Tipi i kontratës - Shërbime

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

Studim Projektme në programin e Kulturës dhe Turizmit”.

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT
(CPV): 22114311-5 - Projekte**

VLERA E FONDIT LIMIT:

Fondi limit/vlera e pritshme e kontratës: **23,992,185.83 (njëzet e tre million e nëntëqind e nëntëdhjetë e dy mijë e njëqind e tetëdhjetë e pesë presje tetëdhjetë e tre) lekë pa tvsh**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Tiranë, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 12*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 5 ;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme): Sipas Shtojcës 12

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", si dhe nenit.....

(shënim: *plotësoni nëse është rasti, aktin konkret ligjor ose nëligjor që parashikon plotësimin e ndonjë kërkesë specifike për ushtrimin e veprimtarisë profesionale në fjalë*).

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2020, 2021,2022 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% të vlerës së parashikuar të kontratës objekt prokurimi.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Lloji i procedure është "Sherbim Konsulence", përcaktimi i vlerës së kërkuar është bërë në mbështetje të nenin 43, pika 2, germa "c" të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" ku përcaktohet se: "40% të vlerës së parashikuar të kontratës në procedurat e prokurimit..... dhe në procedurat e prokurimit "Shërbim Konsulence" si dhe në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet forms elektronike", si dhe në Udhëzimin e Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar është bërë në mbështetje të nenin 43, pika 1 " të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" ku përcaktohet se: " Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare".

2.2.2 Operatori Ekonomike duhet të paraqesë kopje të çertifikuara të bilanceve pozitive të 3 (tre) viteve të fundit ushtrimore (2020, 2021, 2022) të konfirmuara nga autoritetet përkatëse, në të cilat duhet të rezultojë se nuk ka dale me humbje të pakten në dy vite të njëpasnjëshme. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhëne tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

*Ndërsa shoqërimi me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, është bërë duke iu referuar parashikimit në nenin 41 shkronja c” të Ligjit nr. 1009/2009: “Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikim të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë **dy prej tre treguesve të mëposhtëm:** i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël".*

2.2.3 Vetëdeklarim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2023, sipas Ligjit Nr.9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, nëpërmjet paraqitjes së formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 12.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë se ka paguar detyrimet e taksave vendore për vitin 2023 sipas kësteve të parashikuara në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të DST-së objekt prokurimi.

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Shënim: Operatorët ekonomik të kualifikuar të fazes së parë (lista e shkurtër), duhet të dorëzojnë pranë AK, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet e paraqitura në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar në nenin 77, pika 3, e LPP, nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe ligjin nr.9920 date 19.05.2008 “Për procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 4, pika 2, gërma d)

dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Ky kriter shërben për të garantuar AK se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi, kanë kapacitetet e duhura ekonomike dhe financiare si dhe janë të përshtatshëm për të kryer veprimtari profesionale. Referuar sa më sipër, Autoriteti Kontraktor gjykon se kriteri i vendosur lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të deklaratës për shlyerjen e detyrimeve vendore për vitin 2022, pranë bashkisë/ve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 për “Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari Biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për t’iu nënshtuar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

2.3 Shërbime të ngjashme të realizuara gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, me vlerë jo më të vogël se 40 % e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet.

- a) Për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik do ta vërtetojë këtë shërbim duke paraqitur kontratën përkatëse, vërtetim për realizimin e plotë dhe të suksesshëm të kesaj kontrate.
- b) Kur shërbimi i ngjashëm është realizuar me subjekte private, Operatori ekonomik do ta vërtetojë këtë shërbim duke paraqitur faturat tatimore perkatëse, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Në rastin e procedurave të prokurimit “Shërbim konsulence”, si përvojë e mëparshme për shërbimet e ngjashme me objektin e prokurimit do të njihen dhe/ose shërbimet e ngjashme me fushat përkatëse të ekspertizës, pjesë e objektit të prokurimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe në nenin 54 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Përvoja e ngjashme konsiderohet si kriter thelbësor dhe si rrjedhim operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si referenca/fatura tatimore, për të provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi

2.3.1 Liçensa profesionale të operatorit ekonomik (e vlefshme) për projektim (leshuar nga MZHUT ose nga Institucioni i Autorizuar sipas legjislacionit në fuqi për dhënien e licensave profesionale në fushën e studimit e projektimit në ndërtim), ku të përfshihen kategorite:

2. PROJEKTUES ARKITEKT

- a) Projektim arkitekturor per objekte banimi-objekte industrial-objekte turistike;
- b-1) Objekte sportive te mbuluara ose pjeserisht te mbuluara;
- b-2) Qendra tregtare; objekte social-kulturore; objekte kulti; objekte arsimore;
- c- Projektim interiere;
- d- Projektim peisazhi, sistemim sipërfaqe te gjelberta, lulishte e parqe.

3. PROJEKTUES KONSTRUKTOR

- a) Projektim objekte civile - industriale – turistike prej murature e skelet beton arme deri në 5 kate.
- b) 1. Objekte civile - industriale - turistike mbi 5 kate – 2. objekte me skelet metalik.
- c) 1. Objekte me shkallë të lartë vështirësie Beton arme – metalike – 2. troje dhe shpate me qëndrueshmëri të ulët.
- d) Vlerësimi i kapacitetit mbajtës dhe përforcimi i strukturave mbajtëse prej beton-arme, murature dhe metalike;
- e) Projektim objekte civile e turistike prej druri.

4. PROJEKTUES INSTALATOR

- a) Projektim te instalimeve hidro-termosanitare;
- b) Projektim te instalimeve termoteknike- kondicionimi, si dhe te impianteve te prodhimit te energjise termike nga burime te rinovueshme;
- c) Projektim te linjave e rrjeteve elektrike, per objekte civile e industriale;
- f) Projektim te sistemeve kundra zjarrit.;
- h) Projektimi i impianteve ngritese e transportuese (ashensore, shkalle levizese, etj.);
- i) Projektimi i ndricimit rrugor, shesheve, dekorativ, ndricimit te objekteve te medha sportive, porteve aeroportive, etj.;
- j) Projektim te rrjeteve te telefonise, citofonise, fonise, internetit, TV, access kontroll, CCTV, sistemet e alarmit, sistemet e dedektimit te zjarrit, etj., per objektet civile dhe industriale.

5. PROJEKTUES VEPRA HIDRAULIKE

- b) Projektim furnizim me ujë – kolektorë shkarkimi.

8. PROJEKTUES GJEODET

- a) Rilevime inxhinierike
- b) Rilevime inxhinierike kadastrale
- c) Sistemet GIS

9. STUDIM GJEOLIGO INXHINIERIK - HIDROGJEOLOGJIK

- a) Studim/vlerësim gjeologo-inxhinierik i truallit për objekte civile – ekonomike deri 5 kate.

- b) Studim/vlerësim gjeologo-inxhinierik i truallit për objekte civile - ekonomike mbi 5 kate.
- d) Studim/vlerësim gjeologo-inxhinierik i trojeve të buta dhe shpateve me qëndrueshmëri të ulët

10.PROJEKTIMI I IMPIANTËVE TË PRODHIMIT DHE SHPËRNDARJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE

- e) Projektim kabina elektrike të rrjetit shpërndarës – linja të tensionit të ulët – të mesëm.

12. STUDIME TË SIZMOLOGJISË INXHINIERIKE

- b) Studime/vlerësime gjeologo-sizmike për trojet ku ndërtohen objektet civile, sociale e kulturore.

(Për Operatorët e huaj të bëhet njehsimi i licencës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë institucionit përkatës, në plotësim të licencave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës).

*Sqarim: Për licencat e lëshuara pas hyrjes në fuqi të Vendimit nr.943, datë 28.12.2016 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.759, datë 12.11.2014, të Këshillit të Ministrave ‘Për licencimin profesional të individëve dhe personave juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë **Liçensa profesionale të shoqërisë (e vlefshme) për projektim (leshuar nga MZHUT** ose institucione të tjera të autorizuara sipas legjislacionit në fuqi për dhënien e licensave profesionale në fushën e studim projektimit në ndërtim), e vlefshme, ku të përfshihen kategoritë e mësipërme me ndryshimet përkatëse në emërtesë.*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe vendimin nr.759, datë 12.11.2014 të Këshillit të Ministrave, “Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e koaludimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, ndryshuar me VKM-në nr.943 datë 28.12.2016” (shënim- përcaktoni aktin ligjor ose nënligjor specifik dhe nenin përkatës, që parashikon licencimin e subjekteve, në lidhje me veprimtarinë përkatëse për realizimin e shërbimeve objekt kontrate).

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente.

Kategoria e kërkuar	Pikat e kategorise	Pershkrimi per kategorite
---------------------	--------------------	---------------------------

Projektues Arkitekt	a) Projektim arkitekturor per objekte banimi-objekte industrial-objekte turistike;	<i>Projektim arkitektonik per objekte turistike.</i>
	b-1) Objekte sportive te mbuluara ose pjeserisht te mbuluara;	<i>Projektim arkitektonik i fushave sportive te jashtme te objekteve turistike, kulturore etj.</i>
	b-2) Qendra tregtare; objekte social-kulturore; objekte kulti; objekte arsimore;	<i>Projektim arkitektonik i objekteve kulturore, turistike etj.</i>
	c- Projektim interiere;	<i>Projektim i mobilimit te brendshem nga ana funksionale.</i>
	d- Projektim peisazhi, sistemim siperfaqe te gjelberta, lulishte e parqe.	<i>Do perdoret per sistemim te mbjenteve te jashtme ne monumentet e kultures</i>
Projektues Konstruktor	a) Projektim objekte civile - industriale – turistike prej murature e skelet beton arme deri në 5 kate.	<i>Projektim I strukturave objekteve turistike(me lartesi deri ne 5 kate.</i>
	b) 1. Objekte civile - industriale - turistike mbi 5 kate – 2. objekte me skelet metalik.	<i>Projektim I strukturave te objekteve kulturore turistike, me lartesi mbi 5 kate, projektimi strukturor I strukturave metalike pjese e objekteve kulturore .</i>
	c) 1. Objekte me shkallë të lartë vështirësie Beton arme – metalike – 2. troje dhe shpate me qëndrueshmëri të ulët.	<i>Projektim I strukturave dhe jo vetem me nje shkalle te larte veshtiresie strukturore pershtatur kjo me format arkitektonike te objekteve. Parashikimi I projektit strukturor per objektet kryessiht ne zona rurale te shtrira ne truall relativisht kondrinor ose malor me shkalle veshtiresi te realizimit te projektit konstruktiv.</i>
	d) Vlerësimi i kapacitetit mbajtës dhe përforcimi i strukturave mbajtëse prej beton-arme, murature dhe metalike;	<i>Projektim I nderhyrjeve ne struktura ekzistuese per rritjen e aftesise mbajtese sizmike dhe jo vetem te elementeve strukturor.</i>

	e) Projektim objekte civile e turistike prej druri.	<i>Sistemim i monumenteve te kultures qe mund te kene edhe elemente prej druri</i>
Projektues Instalator	a) Projektim te instalimeve hidro-termosanitare;	<i>Realizimi I projekteve per instalimet hidro termo sanitare (tualetet ne objektet arsimore, dushet ne paletra etj)</i>
	b) Projektim te instalimeve termoteknike-kondicionimi, si dhe te impianteve te prodhimit te energjise termike nga burime te rinovueshme;	<i>Projektimi I impianteve te ngrohjes ne objektet kulturore turistike dhe jo vetem, Projektim I sistemeve te burimeve te rinovueshme sip panele diellore etj.</i>
	c) Projektim te linjave e rrjeteve elektrike, per objekte civile e industriale;	<i>Projektim I rrjeteve elektrike dhe sistemeve elektrike ne godina</i>
	f) Projektim te sistemeve kundra zjarrit.;	<i>Projektim I sistemeve te mbrojtjes nga zjarri, me sisteme qendrore hidraulike apo me bombula. Sisteme te modernizuara antizjarr.</i>
	h) Projektimi i impianteve ngritese e transportuese (ashensore, shkalle levizese, etj.);	<i>Projektim I ashensoreve, ne objektet kulturore kryesisht ne funksion te personave ne nevoje. Apo impianteve te tjera ne funksion te ketyre kategorive.</i>
	i)Projektimi i ndricimit rrugor, shesheve, dekorativ, ndricimit te objekteve te medha sportive, porteve aeroportive, etj.;	<i>Sistemim I ambjenteve te jashtme me ndricim.</i>
	j) Projektim te rrjeteve te telefonise, citofonise, fonise, internetit, TV, access kontroll, CCTV, sistemet e alarmit, sistemet e dedektimit te zjarrit, etj., per objektet civile dhe industriale.	<i>Projektim I sistemeve te alarmit dhe detektimit te tymit, sistemeve te internet telefonise etj. Cdo instalim tjeter I telefonise, fonise, access kontroll ne keto kategori objektesh.</i>

Projektues i Veprave Hidraulike	b) Projektim furnizim me ujë – kolektorë shkarkimi.	<i>Projektmi I sistemeve te furnizimit me uje ne objekte dhe te shkarkimi te ujerave te perdorura. Lidhja me rrjetet kryesore dhe krijimi I infrastruktures se nevojshme per mirefunksionimin e objekteve.</i>
Prorektues gjeodet	a) Rilevime inxhinierike	<i>Rilevime inxhinierike per te gjithë ketegorite e objekteve subject I kesaj procedure</i>
	b) Rilevime inxhinierike kadastrale	<i>Rilevime inxhinierike kadastrale per efekt te aplikimeve per leje ndertimi apo procedurave te ngjashme te parashikuara ne projektimet e kesaj kategorie objektesh.</i>
	c) Sistemet GIS	<i>Sistemet Gis e referuara per te gjithë objektet subject I projektimit.</i>
Studim Gjeologo-Inxhinierik Hidrologjik	a) Studim/vlerësim gjeologo-inxhinierik i truallit për objekte civile – ekonomike deri 5 kate.	<i>Studim dhe vleresim I gjeologjis se truallit ku ndodhet objekti ekzistues apo pritet te ndertohe objekti I ri max deri ne lartesine 5 kate</i>
	b) Studim/vlerësim gjeologo-inxhinierik i truallit për objekte civile - ekonomike mbi 5 kate	<i>Studim dhe vleresim I gjeologjis se truallit ku ndodhet objekti ekzistues apo pritet te ndertohe objekti I ri max deri ne lartesine mbi 5 kate</i>
	d) Studim/vlerësim gjeologo-inxhinierik i trojeve të buta dhe shpateve me qëndrueshmëri të ulët	<i>Studim gjeologjik simbas vendodhjes se objektit</i>
	10. Projektimi i Impianteve te Prodhimit dhe Shperndarjes se Energjise Elektrike	e) Projektim kabina elektrike të rrjetit shpërndarës - linja të tensionit të ulët - të mesëm.
12. Studime te Sizmologjise Inxhinierike	b) Studime/vlerësime gjeologo-sizmike për trojet ku ndërtohen objektet civile, sociale e kulturore.	<i>Studime dhe vleresime te sizmologjise per objektet subject I kesar procedure (objekte kulturore)</i>

2.3.2 Operatori Ekonomik duhet te ketë si drejtues teknik stafin si më poshtë dhe te jenë te perfshirë ne listpagesën e shoqërisë për muajin e fundit te deklaruar:

- 1 (nje) Arkitekt;
- 1 (nje) Inxhinier Ndertimi;
- 1 (nje) Inxhinier Hidroteknik;
- 1 (nje) Inxhinier Gjeodet;
- 1 (nje) Inxhinier Gjeolog
- 1 (nje) Inxhinier Elektrik;
- 1 (nje) Inxhinier Mekanik;

Per stafin e mesiperm Operatori Ekonomik duhet te paraqese:

Kontratrat individuale te punes (të vlefshme), Licencat profesionale, Diplomë .

Një projektues nuk duhet të jetë i angazhuar njëkohësisht në stafin e dy shoqërive që marrin pjesë në procedurën e prokurimit.

Stafi i angazhuar të paraqesë deklaratë disponueshmërie për kryerjen e shërbimeve që ka marrë përsipër të realizojë (shtojca 7).

Shënim: Sqarojmë se në përmbushjen e kriterit të sipërcituar, operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës nr.12, ku të deklarohet disponimi i punonjësit të sipërcituar.

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Shënim: Operatorët ekonomik te kualifikuar te fazes se pare (lista e shkurtër), duhet te dorezojnë pranë AK, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet e paraqitura në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Njesia e prokurimit per vendosjen e stafit i eshte referuar Termave te references dhe pikave te licenses te kerkuara ne piken 2.3.1.

- Punimet per sherbimin e projekteve strukture kane gjithashtu nje volum te rendesishem, pasi kryesisht parashikohet te kemi realizim te objekteve me shkalle te ndryshme veshtiresie te cilat kerkojne gjykim dhe punime te specializuara ne fushen e projektimit strukturor per te cilen kerkohet dhe staf ndihmes. Inxhinieri i profilit

Strukturist do te duhet dhe ne projektimin e nderhyrjeve te reja si rrjedhoje gjykohet qe duhet te pakten **1 (nje) inxhinier ndertimi** , pjese e stafit teknik.

- Sherbimet per projektimin arkitektonik priten te kene nje volumin te moderuar te projekteve qe realizohen per nivelin e objekteve dhe realizimit te peizazhit subjekt i kesaj procedure, si objekte te nje kategorie te vecante per te cilen gjykohet si e nevojshme prezenca e te pakten **1 (nje) Arkitekti** si staf teknik (arkitekthe godinash, peisazhi, etj).
- Punimet per studimin dhe vleresimin gjeologjik do te jene te pranishme kryesisht ne vleresimin gjeologjik per vlersimin, si rrjedhoje gjykohet si e nevojshme prezenca e te pakten **1 nje inxhinieri gjeolog**, si staf teknik.
- Punimet per sherbimin e projektimit topografik do te jene nje ze i rendesishem ne realizimin e projekteve qe parashikohen te kene dhe volume te konsiderueshme te punimeve topografike si rrjedhoje gjykohet si e nevojshme prezenca e te pakten **1 (nje) gjeodet**, si pjese e stafit teknik.
- Punimet per sherbimin e projektimit hidroteknik do te jene nje ze i rendesishem ne realizimin e projekteve qe parashikohen, si rrjedhoje gjykohet e nevojshme prezenca e te pakten **1 (nje) inxhinieri hidroteknik**, si pjese e stafit teknik.
- Punimet per sherbimin e projektimit te sistemeve elektrike parashikohen bazuar ne termat e references, si rrjedhoje gjykohet si e nevojshme prezenca e te pakten **1 (nje) inxhinieri elektrik**, si pjese e stafit teknik.
- Punimet per sherbimin e projektimit te sistemeve mekanike parashikohen bazuar ne termat e references, si rrjedhoje gjykohet si e nevojshme prezenca e te pakten **1 (nje) inxhinieri mekanik**, si pjese e stafit teknik.

2.3.3 Operatori Ekonomik ofertues duhet te kete si staf mbështetës si më poshtë:

- 2 (dy) Arkitektë;
 - 1 (nje) Inxhinier Ndërtimi Profili Strukturist;
 - 1 (një) Inxhinier Gjeolog/Gjeofizik/Sizmiolog;
 - 1 (një) Inxhinier Gjeodet/Markshajder/Topograf;
 - 1 (një) Inxhinier Hidroteknik;
 - 1 (një) Ekspert Zjarrëfikës;
 - 1 (një) Inxhinier IT/Telekomunikacion/Elektronik/Sistemesh.
 - 1 (një) punonjës të pajisur me certificate lëshuar nga Ministria e Mjedisit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis.
- 1 (nje) Auditues energjetik i Certifikuar nga Agjensia per Eficensen e Energjise per te kryer auditime ne Ndertesa;

Per punonjësit e mesiperm Operatori Ekonomik duhet te paraqese:

Kontratrat individuale te punes (të vlefshme), Diplomë, CV

Shënim: Sqarojmë se në përmbushjen e kriterit të sipërcituar, operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës nr.12, ku të deklarohet disponimi i punonjësit të sipërcituar.

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Shënim: Operatorët ekonomik të kualifikuar të fazes së parë (lista e shkurtër), duhet të dorëzojnë pranë AK, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet të paraqitura në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.

Një projektues nuk duhet të jetë i angazhuar njëkohësisht në stafin e dy shoqërive që marrin pjesë në procedurën e prokurimit.

Stafi i angazhuar të paraqesë deklaratë disponueshmërie për kryerjen e shërbimeve që ka marrë përsipër të realizojë (shtojca 7).

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohej që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Njesia e prokurimit për vendosjen e stafit ndihmës i është referuar Termave të referencës dhe shkallës së vështirësisë për objektet që parashikohen të jenë pjesë e kesaj marreveshjeje dhe efektshmerine në projektimin me sukses të tyre.

- Shërbimet për projektimin arkitektonik priten të kenë volum të madh të projekteve që realizohen për nivelin e detajeve arkitektonike për kategoritë e objekteve subjekt i kesaj procedure, si objekte të një kategorie të vecante për të cilën gjykohej si e nevojshme prezenca e të paktën **2 (dy) Arkitektheve** si staf ndihmës (arkitekthe godinash, interieri, peisazhi, etj)
- Punimet për shërbimin e projekteve strukturore kanë gjithashtu një volum të rëndësishëm, pasi kryesisht parashikohet të kemi realizim të objekteve me shkallë të ndryshme vështirësie të cilat kërkojnë gjykim dhe punime të specializuara në fushën e projektimit strukturor për të cilën kërkohej dhe staf ndihmës. Inxhinieri i profilit Strukturist do të duhet dhe në projektimin e godinave të reja si rrjedhojë gjykohej që duhet të paktën **1 (një) inxhinier ndertimi profili strukturist** pjesë e stafit ndihmës.
- Punimet për shërbimet që ofrohen nga inxhinieri gjeolog/ gjeofizik/ sizmiolog bazuar pikave të licencës së kërkuara konkretisht për punime dhe vlerësime të inxhinierisë gjeologjike – sizmike, vlerësimet gjeoteknike të trojeve do të jenë të nevojshme të realizohen, konkretisht në këto objekte meqenëse kemi edhe ndertimin e objekteve të reja si dhe të natyrave të ndryshme inxhinierike me themele të thella (parkimi nëntokësor, apo objekte me shumë shtete në tokë lind nevojë e prezencës së **1 një specialisti inxhinier gjeolog/ sizmiolog/ inxhinier gjeofizik** si staf ndihmës për kategoritë e sipërcituar për vlerësimin gjeologjik – sizmiologjik.
- Punimet për shërbimin e projektimit topografik do të jenë një zë i rëndësishëm në realizimin e projekteve që parashikohen të kenë dhe volume të konsiderueshme të

punimeve topografike si rrjedhoje gjykohet si e nevojshme prezenca e te pakten **1 (nje) gjeodet/markkshajder/topograf** si pjese e stafit ndihmes.

- Punimet per sherbimin e projektimit hidroteknik do te jene te pranishme per realizimin e nyjeve sanitare, furnizim me uje, kolektore shkarkimi etj, si rrjedhoje gjykohet e nevojshme prezenca e te pakten **1 (nje) inxhinieri hidroteknik** si pjese e stafit ndihmes.
- **Eksperti zjarrfikes** eshte i domosdoshem te jete prezent gjate hartimit te projekteve te mbrojtjes ndaj zjarrit dhe vleresimeve perkatese te fushes bazuar ne termat e references

- Punimet per sherbimin e projektimit te sistemeve te telekomikacionit, internet, telefoni, radiofoni, sisteme audio vizive, me projektore etj parashikohen bazuar ne termat e references. Si rrjedhoje gjykohet si e nevojshme prezenca e te pakten **1 (nje) Inxhinier IT/Telekomunikacion/Elektronik/Sistemesh.**
- Punimet per sherbimin e projektimit te sistemeve elektrike parashikohen bazuar ne termat e references, si rrjedhoje gjykohet si e nevojshme prezenca e te pakten **1 (nje) inxhinieri elektrik**, si pjese e stafit ndihmes.
- **1 (nje) punonjës të pajisur me certificate lëshuar nga Ministria e Mjedisit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis**, gjykohet si i domosdoshem pre realizimin e VNM (Vleresimet e ndikimit ne Mjedis) per projektet qe do te realizohen.
- **1 (nje) Auditues energjetik i Certifikuar nga Agjensia per Eficensen e Energjise per te kryer auditime ne Ndertesa** eshte i domosdoshem pasi per cdo objekt te ri dhe qe do ti nenshtrohet punimeve per ndertim apo rikonstruksion do te nevojitet Studimi per Eficencen e Energjise.

2.3.4 Operatori Ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij të paktën 20 (njëzet) punonjës për muajin fundit të deklaruar, të vërtetuar me:

- a) Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për periudhen e fundit të deklaruar.
- b) Listpagesat e punonjesve te konfirmuara nga autoritetet perkatese sipas formatit qe kerkohet nga legjislacioni ne fuqi per per periudhen e fundit të deklaruar.

Shënim: Sqarojmë se në përmbushjen e kriterit të sipërcituar, operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës nr.12, ku të deklarohet disponimi i punonjësve të sipërcituar.

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Shënim: Operatoret ekonomik te kualifikuar te fazes se pare (lista e shkurtër), duhet te dorezojnë pranë AK, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet te paraqitur në formularin

përmbledhës të vetëdeklarimit si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. Numri i përcaktuar i punonjësve është përlllogaritur si më poshtë: per percaktimin e fuqise punëtore minimale te kerkuar argumentojme se jemi bazuar ne sherbimet e kerkuara sipas Termave te References dhe stafin e permendur ne pikat e mesiperme *Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë, tregon besueshmëri për autoritetin. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë çdo dëshmi me këtë kohështrirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve dhe përvojën e tyre, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës.*

2.3.5 Operatori ekonomik ofertues duhet te jete i pajisur dhe te paraqese Certifikatat te pershtatshme **ose ekuivalentet e tyre** per objektin e prokurimit si me poshte:

- a) ISO 9001: 2015, Per menaxhimin e cilesise;
- b) ISO 14001: 2015, Per menaxhimin e cilesise se mjedisit;
- c) ISO 18001-2007, ekuivalente me ISO 45001-2018 (e vlefshme). Sistemi i Menaxhimit për Shëndetin dhe Sigurinë në Punë;
- d) ISO 50001-2011, Sistemi i Menaxhimit të Energjisë;
- e) PAS 99:2012, Sistemi i Menaxhimit të Integruar

Shënim: Në rastet e Bashkimit te Operatoreve ekonomik çdo anëtar i grupit duhet të paraqese certifikatën e mësipërme në bazë të zërave të marrë përsipër të realizoje sipas marrëveshjes së bashkëpunimit.

Argumentimi: *Kerkesat e mesiperme jane vendosur bazuar ne Nenin 79, pika 1 te Ligjit Nr. 162/2020, “Per prokurimin publik”, sipas të cilit: “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”, si dhe ne zbatim te Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”*

Çertifikatat e cilesise jane bazuar ne perputhje jane ne perputhje me natyren dhe objektin e kontrates qe prokurohet.

2.3.6 Operatori Ekonomik duhet të ketë në pronësi ose me qera:

- 2(dy) Pajisje për matjet gjeodezike GPS;
- 1(një) Pajisje për matjet gjeodezike Total Station.

Për plotësimin e kësaj kërkesë duhet të paraqitet një dokument i cili vërteton pronësinë ose aktin e marrjes me qera të tyre si dhe skeda teknike e këtyre pajisjeve.

Shënim: Sqarojmë se në përmbushjen e kriterit të sipërcituar, operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës nr.12, ku të deklarohet disponimi i punonjësve të sipërcituar.

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Shënim: Operatoret ekonomik te kualifikuar te fazes se pare (lista e shkurtër), duhet te dorezojnë pranë AK, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet te paraqitur në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për shërbimet objekt prokurimi, që do të përfshihen në termat e referencës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.